

Nr.regj. 24982/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Ahmet Brovina nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 6.2 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik e Pasurisë, Nr. 03/L-151, në bazë të nenit 73,74, 195,199 dhe nenit 198.1.1 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë **12.12.2011** merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Ahmet Pajazit Brovina, i lindur më 08031950 në fshatin Brovinë, tani jeton në Prishtinë, me vendbanim në rrugën "Shaip Spahia" nr.47, me shkollim superior, doktor në Klinikën Interne-QKUK në Prishtinë, i martuar, babë i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike,

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepse, si zyrtar i lartë publik, në pozitë të Ushtruesit të Drejtorit të Klinikës së Mjekësisë Interne, nuk ka bërë deklarinimin e rregullt të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion, brenda afatit ligjor deri më datën 31.03.2011, - **me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 6.2 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik,**

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse ndaj Ahmet Pajazit Brovina për kundërvajtje nga neni 7.1 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, komfor nenit 198.1.1 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, pasi që me datë 09.12.2009 kur Ahmet Brovina ka marrë detyrën e U.D të Klinikës Interne në QKUK, mosdeklarimi i pasurisë në Agjencinë Antikorrupsion, pas marrjes së detyrës në afat prej 60 ditësh, nuk ka qenë me ligj të veçantë e përcaktuar si kundërvajtje.

Andaj, të pandehurit për kundërvajtje nga neni 6.1 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1.1. të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, i shqiptohet,

D Ë N I M I

Me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind euro), të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formë e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së No.1000 4300 7000 0518. Pagesa bëhet në ndonjërin agjenci për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **26 ditësh**, duke llogaritur nga 15 Euro për një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumë prej **5 Euro** në shërbimin e arkës së gjykatës.

Nga një kopje e këtij aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsion në Prishtinë, i parashtrori kësaj gjykate kërkesën 01/3228.2011 me datë 19.07.2011 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartshënuar për kundërvajtjet nga neni 6 dhe 7 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik e Pasurisë, meqë i njëjti në Agjencinë kundër Korrupsion nuk e ka dorëzuar formularin mbi deklarinimin e pasurisë pas marrjes së detyrës me datë 09.12.2009 e as formularin mbi deklarinimin e rregullt të gjendjes së pasurisë deri më datën 31.03.2011.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. _____	Nr. Prot. _____
Dep. <u>D.P</u>	Br. Prot. <u>03-112/2012</u>
Dep. _____	Prot. Nr. _____
Nr. i faq. _____	Data _____
Broj stranica <u>01</u>	Datum <u>16-01-2012</u>
Nr. pages _____	Dot. _____
PRISHTINE	

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se e kundërshton kundërvajtjet të cilat rrihen në barrë me kërkesë të AKK, ngase nuk ka qenë i njoftuar se i njëjti ka obligim të bëjë deklarinimin e pasurisë. Në vazhdim i pandehuri thekson se duke qenë vetëm ushtrues detyre i drejtorit të Klinikës Interne, as që ka menduar për çfarëdo deklarimi të pasurisë, ngase askush nga administrata e QKUK nuk e ka njoftuar për këtë çështje.

Për të vërtetuar gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, gjyqtarja dëgjoi zyrtarin e lartë të Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë, në cilësi të dëshmitarit, i cili deklaroi se me datë 08.03.2011 kishte dërguar një emial shefit të Personelit të QKUK, së bashku me njoftimin e AKK që ka të bëjë me zyrtarët e lartë publik, formularin e bashkangjitur si dhe listën e zyrtarëve të lartë. Gjithashtu gjyqtarja dëgjoi edhe shefin e personelit të administratës së QKUK, në cilësi të dëshmitarit, i cili deklaroi se asistentja e tij me datë 09 dhe 10.03.2011 nëpërmjet telefonit i kishte njoftuar të gjithë të adresuarit sipas listës ku ishte edhe emri i dr.Ahmet Brovinës dhe për këtë çështje dëshmitari prezanton edhe deklaratën e asistentes së tij. Lidhur me çështjen e deklarinimit të pasurisë dhe detajet tjera për zyrtarët e lartë të QKUK, dëshmitari thekson se personalisht e kishte njoftuar edhe drejtorin ekzekutiv të QKUK në dy mbledhjet e Bordit të mbajtura me datë 08 dhe 09.03.2011. Për plotësim të kërkesës së parashtruar nga AKK, është dëgjuar edhe përfaqësuesi i AKK i cili sipas autorizimit të datës 02.11.2011, në gjykatë prezantoi Aktvendimin e datës 09.12.2009 të lëshuar nga QKUK për caktimin e dr.Ahmet Brovinës si U.D i detyrës së drejtorit të Klinikës Interne në QKUK.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehurit dhe deklaratës së dëshmitarëve si dhe administrimit të provave nga shkresat e lëndës, veçmas dhe të gjitha së bashku, gjyqtarja në masë të mjaftueshme vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, konstatoi se i pandehuri nuk ka bërë deklarinimin e rregullt të pasurisë deri me datë 31.03.2011, ngase sipas ligjit në fuqi nga obligimi i deklarinimit të rregullt të pasurisë nuk lirohen as ushtruesit e detyrës, andaj ky fakt i prezantuar nga i pandehuri paraqet vetëm justifikim të gjendjes joreale. Nga ana tjetër botërisht ka qenë e njohur çështja e deklarinimit të pasurisë dhe format e saj nëpërmjet medimeve dhe web faqes së AKK, andaj gjyqtarja nuk ia fali besimin thënieve të pandehurit, por vendimin e precizuar si në diapozitiv, e mbështeti kryesisht në deklarata të dëshmitarëve, andaj të pandehurin e shpalli përgjegjës dhe e dënoi me gjobën e paraparë ligjore vetëm sa i përket kundërvajtjes nga neni 6.2 të ligjit përkatës. Sa i përket kundërvajtjes nga neni 7.1 të të njëjtit ligj gjyqtarja bëri Pezullimin e procedurës komfor neni 198.1.1 të LK, pasi që në vitin 2009 mosdeklarinimi i pasurisë nuk ka qenë e sanksionuar si vepër kundërvajtëse.

Gjatë shqiptimit të dënimit gjyqtarja pati parasysh rrethanat nga neni 7 i LK në të cilat është kryer kundërvajtja dhe duke vlerësuar masën e shkëljes sipas pozitës së zyrtarit të lartë publik si dhe personalitetin e tij, të njëjtit ia shqiptoi dënimin me gjobë të precizuar si në dispozitiv, me bindje se edhe me një gjobë të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit dhe se i pandehuri në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e ndonjë kundërvajtjeje të tillë apo të ngjashme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr. regj.24982/2011, datë 12.12.2011

Gjyqtarja

Suzana Çerkini

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh nga data e pranimit të të njëjtit në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.

